

Vendim nr. 31 datë 13.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 13.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 30 (B) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BARDHYL IBRA**

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm të parashikuar nga nenet 399/6, shkronja “c” dhe 399/7, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile, të kërkesës nr. 5/2021 regjistri themeltar, datë 29.12.2021 të Gjykatës së Lartë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); nenet 27 e 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, zonjës Enkelejda Kapedani, gjyqtare

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, zotit Ylli Manjani, ministër i Drejtësisë, zonjës Ardita Shehaj, drejtore e drejtorisë për të drejtën e informimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke kërkuar detyrimin e të paditurve për dhënie informacioni të kërkuar nga ai, si dhe për dëmshpërblimin në mënyrë solidare të dëmit të shkaktuar në vlerën 500,000 lekë.

2. Me vendimin nr. 5917, datë 12.12.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur, ndër të tjera: *“Kthimin e padisë paditësit Bardhyl Ibra pa veprim, së bashku me aktet shoqëruese të saj.”*

3. Kërkuesi ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili është regjistruar me nr. 31025-00563-86-2017, datë 08.02.2017. Në kushtet kur ankimi i tij nuk po shqyrtohej nga kjo gjykatë, në datën 11.12.2019 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe detyrimin e kësaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit të saj. Kërkesa është regjistruar me nr. 18/24/16 regjistri themeltar të kësaj gjykate.

4. Gjatë kohës që pritej shqyrtimi i kërkesës nga ana e Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka paraqitur dy ankime në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) për të njëjtin proces gjyqësor, përkatësisht në datat 27.04.2020 dhe 23.06.2021. Me vendimin nr. 15, datë 05.02.2021, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se për procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk kishte ende një vendim përfundimtar dhe të formës së prerës, sipas parashikimeve të nenit 399/8 të KPC-së, ndërsa me vendimin nr. 109, datë 27.09.2021, Kolegji tjetër i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se vendimi i pranimit ose jo të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes, nuk është përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues, pasi nuk vendos në mënyrë përfundimtare për themelin e saj.

5. Në vijim, me vendimin nr. 18/24/16, datë 22.12.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit të datës 11.12.2019. Ky vendim rezulton t'i jetë komunikuar kërkuesit nga Gjykata e Lartë në datën 07.02.2022.

6. Në datën 29.12.2021 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt: *“Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar në pikën 2 të nenit 399/7 të KPC të kërkesës sime nr. regjistrimi 24, datë 11.12.2019 pranë sekretarisë suaj dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes sa më parë të jetë e mundur.”*. Kjo kërkesë është regjistruar në këtë gjykatë me nr. 5/2021 regjistri themeltar.

7. Po kështu, në datën 13.05.2022 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit

të çështjeve të tij nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Me vendimin nr. 77, datë 06.07.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim, me qëllim saktësimin dhe qartësimin e së drejtës kushtetuese ose interesit kushtetues ose të ligjshëm, që qëndron në thelb të procesit të tij gjyqësor. Pas plotësimit të saj, me vendimin nr. 131, datë 12.10.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij, në drejtim të dëmit/pasojave të drejtpërdrejta dhe reale të ardhura nga aktet e kundërshtuara.

8. Ndërkohë, për kërkesën e tij të datës 29.12.2021, me vendimin nr. 5, datë 19.07.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit, me arsyetimin se çështja ishte marrë në shqyrtim dhe ishte gjykuar në themel në datën 22.12.2021 dhe, për rrjedhojë, kërkesa e dytë e tij kishte mbetur pa lëndë dhe objekt gjykimi.

9. Në datën 30.11.2022 kërkuesi i është ridrejtuar Gjykatës me kërkesë sipas objektit, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë të çështjes së tij me nr. 5/2021 regjistri themeltar, datë 29.12.2021.

II

Pretendimet e kërkuetit

10. **Kërkuesi** ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi shqyrtimi i kërkesës së tij nr. 5/2021 regjistri themeltar, datë 29.12.2021 është bërë nga Gjykata e Lartë tej afatit të arsyeshëm të parashikuar në nenin 399/7, pika 2, të KPC-së.

10.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi nr. 18/24/16, datë 22.12.2021 i është komunikuar nga Gjykata e Lartë tej afatit të arsyeshëm.

10.3. *Së drejtës së ankimit*, për shkak të mospranimi të kërkesave të tij për konstatimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e procedurave.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuetit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo

individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

13. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike, të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Për plotësimin e këtij kriteri kërkuuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se individ duhet t’i shfrytëzojë ato përpara se t’i drejtohet asaj. Megjithatë, duke qenë këto mjete të reja, si dhe duke pasur parasysh qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështje të kësaj natyre, Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi të saj (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 39, datë 09.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar konstatimin e shkeljes së standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë për çështjen e tij me nr. 5/2021 regjistri themeltar, datë 29.12.2021, e cila, në vetvete, kishte të bënte me kërkesën e tij nr. 18/24/16, datë 11.12.2019 për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit për çështjen nr. 31025-00563-86-2017, datë 08.02.2017 të tij. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet në dispozicion para se t’i drejtohet Gjykatës.

17. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Kolegji konstaton se vendimi nr. 5, datë 19.07.2022 i është komunikuar kërkuesit në datën 03.08.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 30.11.2022, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi kundërshton procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, për të cilin, me vendimin nr. 5, datë 19.07.2022, është vendosur pushimi i gjykimit për kërkesën tij për shkeljen, nga kjo gjykatë, të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të kërkesës së tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit.

19. Në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila është vënë në lëvizje për të shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vëren se kërkuesi ka marrë përgjigje me vendimin nr. 131, datë 12.10.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, pajisja e tij me një vendim të ri nga Gjykata e Lartë, që nuk ka qenë pjesë e ankimit të mëparshëm kushtetues, edhe pse një fakt i ri, nuk sjell ndonjë ndryshim në lidhje me procesin gjyqësor që ka qenë objekt i vendimit të mëparshëm të kësaj Gjykate.

20. Kolegji vëren, gjithashtu, se kërkuesi i është drejtuar kësaj Gjykate në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur me ankime për të njëjtin proces gjyqësor, duke paraqitur si shkaqe kërkesa të së njëjtës natyrë, që bazoheshin në shumicën e rasteve në vendime jopërfundimtare. Edhe pse me vendime të kolegjeve të kësaj Gjykate i është kërkuar të paraqesë ankim kushtetues kur çështja e tij të jetë përfundimtare ose që të justifikojë interesin për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, duke u konstatuar më pas edhe mungesa e interesit të tij, kërkuesi ka vijuar të paraqesë kërkesa të së njëjtës natyrë dhe për të njëjtat shkaqe, duke shkuar në kufijtë e abuzimit jo vetëm me mjetet ligjore, por edhe me ankimin kushtetues individual.

21. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje të kërkuesit përmbajtjen e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kur Gjykata konstaton se kërkuesi paraqet kërkesë abuzive ose të përsëritur, për të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo është shqyrtuar një herë nga Gjykata, urdhëron gjykitjen e tij dhe në një rast të tillë vendimi përbën titull ekzekutiv.

Kjo dispozitë ka për qëllim të shmangë abuzimin me aksesin kushtetues, si dhe shpërdorimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Megjithatë, në rastin konkret, në kushtet kur kërkuesi nuk është paralajmëruar më parë me vendim të kolegjeve për mundësinë e gjobitjes së tij për shkak të përsëritjes së kërkesave, çmohet se nuk është e arsyeshme të zbatohet neni 31/c i ligjit nr. 8577/2000.

22. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret paraprake, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.